

V E N D I M
Nr. 640, datë 12.12.2002

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 828, DATË 30.12.1998 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR SHITJEN E MJETEVE DHE TË TEKNIKËS LUFTARAKE TË
USHTRISË, TË DALA JASHTË PËRDORIMIT NË FORMËN E SKRAPEVE",
NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 444, DATË 26.9.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14 pika 7 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 828, datë 30.12.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në lidhjen A, në listën që i bashkëlidhet vendimit, numri rendor 2 "Nëndetësja 332, Tufani" dhe numri rendor 4 "Nëndetësja 334, Vetëtim", hiqen nga lista dhe kalojnë e regjistrohen si objekteve muzeale në Muzeun e Forcave Detare, pranë Akademisë së Detarisë, Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano